

Fuqizimi i Shoqërisë Civile përmes Asistencës Teknike për Grantet Operative,
Kosovë
IPA 2015-23/2016

TERMAT E REFERENCËS

Ekspertë afat-shkurtër (EASH)– Fuqizimi i OSHC – Grante Operative, Kosovë

Profili i angazhimit	Ofrimi i asistencës së synuar për organizatat përfituese të granteve operative të financuara nga CSF
Lloji i kontratës	Konsulencë
Kohëzgjatja e detyrës	Maksimum 40 ditë (duke përjashtuar kohën e udhëtimit)
Linja e menaxhimit	Eksperti Kryesor/Udhëheqësi i Ekipit

1. Prapavija

INDEP është një think tank dhe qendër avokimi që ofron zgjidhje të politikave të bazuara në hulumtim të pavarur. E themeluar në vitin 2011 si një asociacion i analistëve të politikave, hulumtuesve dhe aktivistëve të shoqërisë civile, INDEP vëzhgon politikat rajonale me synim të udhëheqjes së vendeve të Evropës Juglindore drejt integritimit Evro-Atlantik. Në Kosovë, ku Instituti është i lokalizuar, INDEP fokusohet veçanërisht në fuqizimin e qeverisjes demokratike dhe e luan rolin e mbikqyrësit të politikave publike. Pavarësisht periudhës së shkurtër të themelimit, INDEP e ka fituar statusin e të qenit një prej akterëve më me influencë të shoqërisë civile në procesin e politikëbërjes në Kosovë. Misioni i INDEP është fuqizimi i zhvillimit të qëndrueshëm socio-politik dhe ekonomik bazuar në parimet e demokracisë dhe vlerave demokratike.

INDEP është mandatar nga Bashkimi Evropian t'u ofrojë asistencë përfituesve të granteve operative të financuara nga CSF¹ për zhvillimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të sistemeve të tyre të qeverisjes dhe llogaridhënies në mënyrë që të jenë Organizata të Shoqërisë Civile të afta, transparente, përgjegjëse dhe efektive.

Qëllimi i përgjithshëm i CSF-së është t'i fuqizojë demokracitë pjesëmarrëse dhe procesin e integritimit evropian në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi përmes fuqizimit të shoqërisë civile për të marrë pjesë aktivisht në vendimmarrje dhe përmes stimulimit të një mjedisi ligjor dhe financiar për shoqërinë civile dhe mediet pluraliste.

¹ Civil Society Facility



Përmes CSF-së 2015, Zyra e BE-së në Kosova për herë të parë ka dhënë grante operative 6 OJQ-ve në Kosovë, me qëllim që të ofrojë mbështetje financiare për funksionalizim efektiv të organizatave dhe implementim të programit vjetor të punës – periudhë ekuivalente me vitin e tyre financiar– në mënyrë që t'i lejojë organizatat të përqendrohen tërësisht në mandatin thelbësor të organizatës së tyre. Këto grante operative do t'i lejojnë organizatat përfituese të ndërtojnë edhe ekspertizë teknike dhe tematike, ashtu si edhe kapacitete organizative, pa pasur nevojë që të fokusohen vazhdimisht në mobilizimin e resurseve. Përmes një procesi të vlerësimit, grantet operative mund të përtërihen në bazë vjetore dhe ta mbështesin financimin për një periudhë maksimale prej 4 vjetësh. Shuma e shpërblyer do të ulet përgjatë viteve.

Me qëllim të sigurimit të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm si dhe të fuqizimit të organizatave përfituese, këto grante operative shoqërohen me Asistencë Teknike për të ndihmuar në konsolidimin e sistemeve të qeverisjes dhe llogaridhënies të organizatave përfituese. Suksesi i organizatave të shoqërisë civile varet shumë nga kredibiliteti dhe llogaridhënia e tyre dhe perceptimi se i mbajnë vlerat që thonë se i përfaqësojnë si demokracia, drejtësia sociale, barazia, transparencja, llogaridhënia, efektiviteti dhe sundimi i ligjit. Standarde të tilla të qeverisjes përfshijnë procesin transparent të vendimmarrjes, në të cilin resurset planifikohen dhe ndahen në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme, bazuar në mision qartë të definuar. Asistenca Teknike mbështetë përfituesit e granteve operative në përpjekjet e tyre për t'i arritur këto standarde. Ajo i ndihmon organizatat për t'i definuar dhe/ose operacionalizuar misionin e tyre, analizimin dhe fuqizimin e strukturave të brendshme qeverisëse dhe metodave dhe standardeve që sigurojnë kualitet duke promovuar kështu standardet më profesionale dhe etike. Nevojat dhe prioritetet e organizatave përfituese, si dhe pikat referencë dhe targetet për t'u ofruar asistencë teknike, duhet të definohen në bashkëpunim dhe konsultim të afërt me përfituesit për të siguruar zotërim, ndikim dhe qëndrueshmëri maksimale.

Asistenca e ofruar për përfituesit e granteve operative të financuara nga CSF do të jetë koherente dhe plotësuese karshi aktiviteteve e mbështetjes së ofruar nga TASCO dhe Qendrës së Burimeve për OSHC në Kosovë.

2. Qëllimi i detyrës

Qëllimi kryesor i kësaj detyre është t'i ofrojë secilës organizate përfituese të granteve operative të financuara nga CSF asistencën e duhur dhe këshilla e ekspertizë të bazuara në planin e dakorduar të punës dhe prioritetet e identifikuara, në mënyrë që të adresohen fushat specifike dhe të dakorduara të zhvillimit dhe të ndërtohen kapacitetet e tyre.

Për këtë qëllim, INDEP kërkon të angazhojë EASH me përvojë, nën udhëheqjen e të cilëve dhe në bashkëpunim me Udhëheqësin e Ekipit dhe INDEP do të ofrojnë asistencën e synuar për OJQ-të përfituese fillimisht në: 1) Menaxhim strategjik 2) Menaxhim Operacional dhe 3) Marrëdhënie me jashtë.

Qasja për zhvillimin e kapaciteteve duhet të jetë përtej perceptimit konvencional të trajnimit dhe të lidhet me konceptin e organizatave mësimnxënëse që përfshinë ndryshime dhe eksperimente të vazhdueshme duke e përdorur feedback-un e proceseve dhe rezultateve, duke i transformuar praktikën dhe vlerat individuale të organizatave dhe përshtatjen e strukturave për t'i përballuar ndryshimet. Andaj, masat për zhvillimin e kapaciteteve duhet të bazohen në ndarjen e njohurive përmes mentorimit, stërvitjes dhe trajnimit në punë dhe të orientohet drejt rezultateve dhe të jetë i qëndrueshëm.



3. Detyrat

Nën udhëheqjen/drejtimin dhe bashkëpunimin me Udhëheqsin e Ekipit/Ekspertin Kryesor, EASH do t'i kryejë detyrat e mëposhtme, që do të definohen më tutje pas përzgjedhjes së kandidatëve të suksesshëm për këtë pozitë:

3.1 Faza fillestare

Të ndërmarrë vizita, hulumtime, intervista të detajizuara, konsultime me OJQ-të përfituese; t'i rishqyrtojë dokumentet strategjike dhe visibilitetin e tyre online dhe të hartojë memorandume të shkurtëra për analizë të situatës specifike që do të rezultojnë në rishikimin/zhvillimin e planeve specifike të punës dhe në një metodologji standarde që do të aplikohet në tërë projektin.

3.2 Menaxhment strategjik

Të ofrojë mbështetje në praktikë për OJQ-të përfituese lidhur me menaxhimin strategjik, funksionimin e bordeve të OJQ-ve, dhe aspekte të tjera strategjike me qëllim të eksplorimit të përbashkët dhe ridefinimit të llojeve të udhëheqjes dhe menaxhimit të OJQ-ve, draftimin e planeve strategjike, dhe definimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse për t'i mbështetur OJQ-të në integrimin e barazisë gjinore.

3.3 Menaxhimi operacional

Të ofrojë mbështetje të strukturuar për OJQ-të përfituese në të gjitha fushat e menaxhimit të brendshëm; menaxhimit financiar, planifikimit dhe raportimit; sigurim të cilësisë përmes Monitorimit, Vlerësimit dhe Mësimin (MVM); duke përfshirë ofrimin e kornizës për të dizajnuar Manualet për Burimet Njerëzore, Dokumentet për Politika Financiare dhe korniza MVM për secilën nga OJQ-të përfituese.

3.4 Marrëdhëniet e jashtme

T'i mbështesë OJQ-të në rritjen e fondeve dhe komunikim, në menaxhimin e marrëdhënieve me donatorë dhe medie, dhe integrimin e përdorimit të IT në aktivitete të përditshme përfshirë zhvillimin e rritjes së fondeve, komunikimit dhe planet/strategjitë për avokim.

3.5 Faza përfundimtare

Të dhënat për hartimin e Raportit të Mësimeve të Marra, duke theksuar të gjeturat dhe rekomantimet kyçe.

3.6 Raportimi

EASH-ve do t'u ofrohen shabllone të raportimit, në bazë të të cilave ata duhet t'i paraqesin raportet (mujore dhe finale) të shkruara në gjuhën angleze.

4. Profili i EASH

Profilet e EASH-ve duhet të përfshijnë ekspertizë, por jo domosdosmërisht të kufizohen, në të mëposhtmet:

- Buxhetimi dhe revizioni financiar;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Planifikimi strategjik;
- Barazia gjinore dhe integrimi gjinor;



- IT dhe komunikimi;
- Avokimi;
- Rishikimi ligjor;
- Rritja e fondeve dhe mobilizimi i resurseve;
- Menaxhimi i rrezikut;
- Zhvillimi organizativ.

Kualifikimet

- Diplomë të Bachelorit në fushat relevante për pozitën e ofruar (juridik, shkenca politike, marrëdhënie ndërkombëtare, shkenca shoqërore ose ekonomik), ose së paku 5 vjet përvojë profesionale relevante mbi minimumin e 5 vjet përvojë profesionale të caktuar më poshtë (në rast se eksperti nuk ka diplomë të Bachelorit);
- Së paku 5 vjet përvojë në fushën relevante për pozitën e ofruar (zhvillimi i shoqërisë civile; analiza ligjore; menaxhim të burimeve njerëore; planifikim strategjik; barazi gjinje; avokim; komunikim; medie; rritja e fondeve; marrëdhënie me donatorë; menaxhim i rrezikut) përveç viteve të përvojës profesionale që shërbejnë si zëvendësim për diplomën, në rast se eksperti nuk e ka diplomën që kërkohet në përputhje me natyrën e pozitës;
- Së paku 5 vjet përvojë në pozita të larta të menaxhimit;
- Përvojë pune në Kosovë ose në vendet e Ballkanit Perëndimor;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme komunikative dhe analitike;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme të gjuhës angleze dhe të qenit i aftë në hartimin e raporteve;
- Aftësi të shkëlqyeshme të punës grupore;
- Aftësitë në gjuhët lokale janë përparësi.

EASH duhet të jenë të pavarur dhe të liruar nga konfliktet e interesit në përgjegjësitë që i marrin.

5. Periudha kohore dhe lokacioni i punës

Periudha e angazhimit është Mars 2017 – Janar 2019. Lokacioni: Kosovë. Data e fillimit të punës është Mars 2017. Për secilin EASH, puna nuk i tejkalon 40 ditë (duke përjashtuar periudhën e udhëtimit).

6. Konfidencialiteti dhe autorësia

INDEP do të ketë autorësi ekskluzive për të gjitha informacionet e nxjerra si pjesë e detyrës. EASH mund t'ua japin informacionet edhe palëve të tjera në instanca të veçanta nëse INDEP pajtohet paraprakisht me shkrim. EASH do t'i trajtojë me konfidencialitet të gjitha informacionet e ofruara nga INDEP, përfituesit e projektit dhe/ose palët e tjera si pjesë e detyrës.

7. Menaxhimi i EASH

EASH do të punojnë nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Ekipit/Ekspertit Kryesor dhe do të punojnë ngushtë me grupin e projektit.

8. Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- Shprehje të interesit që përshkruan motivimin, përvojën relevante, përshtatshmërinë dhe disponueshmërinë për pozitën (max 1 faqe)
- Skicë të metodologjisë së propozuar për t'u përdorur për detyrën, përfshirë edhe sugjerimet e mundshme përveç kërkesave të listuara në KR (max 1 faqe).
- CV në formatin e BE-së.
- Dy referenca nga punë të ngjashme.



- Kompensimi i pritur, në formë të pagesës bruto në Euro në ditë. Ju lutemi ta keni parasysh se koha e udhëtimit prej/në Kosovë nuk do të llogaritet si ditë pune.

Aplikacioni duhet të dërgohet në office@indep.info me subjekt: Aplikim për EASH – asistencë për OJQ-të përfituese të granteve operative të financuara nga CSF. Data e fundit për aplikim është 17:00 CET të dielën, **12 Mars 2017**. Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i
menaxhuar nga Zyra e Bashkimit
Evropian në Kosovë